




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dosturuar Priljezhen/Prodato Received/Delivered	24.01.2023	3	vit god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shifra e Priljez Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPITARR	751/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1154/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1154/2022 të datës 12.12.2022 të parashtruar nga ankuesja

përmes përfaqësuesit me autorizim nga Prizreni, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 24.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1154/2022 e datës 12.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën *Referente e Lartë* në Gjykatën Themelore në Prizren, me datë 12.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7889/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1154/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.30/2022 të datës 26.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit për zyrtarët publikë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shkresave të lëndës gjegjësisht *Flet-kthesa me shenjen KA.01/1806 nga Posta e Kosovës* ka gjetur se pala ankuese Vendimin KA.nr.30/2022 të datës 26.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka pranuar me datë 30.09.2022, ndërsa i njëjti kundër këtij vendimi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar më datë 12.12.2022.



Rrjedhimisht, duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, dhe marr parasysh faktin se ankuesi aktin e kontestuar e ka pranuar me datë 30.09.2022, ndërsa ankesën kundër të njëjtit e ka parashtruar me datë 12.12.2022, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr.1154/2022 është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar prej tridhjetë (30) ditëve, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kështu që duke u bazuar si me lartë dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1154/2022

Sabile Aavdyli
Sabile Aavdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

